



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhës për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1066/2017

Paneli Zgjedhës për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc.Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e Shqipe Alija, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjilan, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Shqipe Alija, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjilan, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, me shenjën ZL.Anr.1066/2017, të datës 13.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 13.10.2017 ka pranuar apelin ZL.Anr.1066/2017 me datën 13.11.2017, nga Shqipe Alija, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjilan, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, në të cilën pretendon se ka votuar në secilën vendvotim VV nr.0403D, pasi që ka më pak vota se sa ka pasur, më tutje ka theksuar se në secilën qendër të votimit nr. 0401D, 0403X, 0402D, 0408D, 0407D, 0403D, , 0401D, 0401X, , 0403X, 0402D, 0409D, dhe sipas KQZ-së ka më pak vota, duke theksuar se ka pasur edhe pa rregullsi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesja në apel me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e saj. Prandaj, Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1066/2017 më datën 13.11.2017.

Kryesues i Panelit

Dr.sc.Rafet Haxhaj



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*